



**VENDIM**

**Nr. 34, Datë 09.03.2016**

**PËR  
FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN DHE MIRATIMIN E  
“RREGULLORES SE PROCEDURAVE TË TRANSFERIMIT TË  
ASETEVE NGA TË LIÇENSUARIT”**

Në mbështetje të neneve 16, 44, pika 2 dhe 108 pika 3 të Ligjit Nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, si dhe neneve 29, pika 2, 116 pika 4 të ligjit nr. 102/2015 ‘Për Sektorin e Gazit Natyror’, dhe nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Proçedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i ERE, në mbledhjen e tij të datës 09.03.2016, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në lidhje me “Rregulloren e Proçedurave të Transferimit të Aseteve nga të Liçensuarit”,

**Vendosi:**

1. Të Miratojë fillimin e proçedurës për shqyrtimin dhe miratimin e “Rregullores se Proçedurave të Transferimit të Aseteve nga të Liçensuarit”.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-s  
Petrit AHMETI**

